Studimi për implementimin e Planit të veprimit për luftë kundër korrupsionit në Komunë të Ulqinit

Botuesit:

OJQ "Ul info"

MOGUL

Për botuesin:

Mustafa Canka

Autor:

OJQ "Ul info"

Redaktor:

Allmir Çausheviq

Tirazhi:

150 ekzemplarë

Ky botim është pjesë e projektit "Ulqini kundër korrupsionit" të cilin e realizon OJQ "Ul info" dhe është përkrahur nëpërmjet programit "Mendo lokalisht – vepro lokalisht" – Lufta kundër korrupsionit në nivel lokal të cilin e realizon Qendra për arsimim qytetarë, në bashkëpunim me OJQ "Bonum" nga Plevla, OJQ "Inkubator" nga Kotorri dhe OJQ "Qendra për gazetari hulumtuese" nga Podgorica, ndërsa e financon Bashkimi europian.

Ky publikim është botuar me përkrahjen e Bashkimit europian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e botuesit dhe në asnjë mënyrë nuk mund të interpretohet si qëndrim zyrtar i Bashkimit europian.

HYRJE

Plani lokal i veprimit (aksionit) për luftë kundër korrupsionit të Komunës së Ulqinit u miratua në mbledhjen e Kuvendit komunal të mbajtur në dhjetor të vitit 2014 si dokument strategjik i cili do të jetë themel për shuarjen dhe parandalimin e korrupsionit në zonën e kësaj vetëqeverisje lokale. Me këtë dokument janë paraparë 39 masa dhe 96 aktivitete, bartësit e tyre, afatet për realizim dhe indikatorët e rezultateve të arritura.

Pak më vonë është formuar Komisioni për luftë kundër korrupsionit i cili kishte detyrim të përcjellë realizimin e masave dhe aktiviteteve nga Plani i veprimit dhe të raportojë për këtë tek organet dhe institucionet lokale dhe shtetërore.

Por, mbas entuziazmit fillestar në vitin 2016, puna e Komisionit praktikisht u ndal.

Plani i integritetit i Komunës së Ulqinit u miratua në vitin 2016 dhe përmban 86 masa të cilat kanë për qëllim zvogëlimin/zhdukjen e rrezikut të krijimit dhe zhvillimit të formave të ndryshme të sjelljes korruptive dhe joetike brenda kësaj vetëqeverisje lokale.

Hulumtimi ynë i zhvilluar me 300 të anketuar në fillim të këtij viti ka treguar se rreth dy të tretat e qytetarëve/eve të Ulqinit nuk janë në dijeni për këto aktivitete edhe pse madje 80% e tyre mendojnë që administrata lokale është shumë ose kryesisht e korruptuar.

Mbi gjysma e të anketuarve nuk kanë dëgjuar për aksionin të cilin Komuna e zbaton në luftë kundër korrupsionit gjersa gati një e treta kanë dëgjuar diçka, por nuk dinë mjaftueshëm. Përveç kësaj, e në pajtim me dy përfundimet paraprake, sipas bindjes të të anketuarve Komuna është shumë ose kryesisht joefikase në luftë kundër korrupsionit (80%). Gati 65% e të anketuarve kanë thënë se nuk kanë dëgjuar dhe nuk dinë që Komuna ka përpiluar planin lokal të veprimit për luftë kundër korrupsionit dhe se ai zbatohet, gjersa vetëm 15% dinë diçka për këtë gjë. Përgjigje të ngjashme janë dhënë edhe në pyetjen rreth Planit të integritetit.

ANALIZA E IMPLEMENTIMIT TË PLANIT LOKAL TË VEPRIMIT PËR LUFTË KUNDËR KORRUPSIONIT

Masa e parë nga Plani i veprimit për luftë kundër korrupsionit në Komunë të Ulqinit për periudhën 2014-2015 parasheh **zbatimin e Ligjit për rregullim hapësinor dhe ndërtim të objekteve**. Indikatorët e rezultateve të arritura për këtë masë janë miratimi i Planit hapësinor – urbanistik (PHU) të Komunës së Ulqinit dhe të dokumenteve lokale planifikuese.

Kuvendi komunal i Ulqinit me Përfundimin numër 02-405/16-4 ka dhënë mendim pozitiv në Propozimin e PHU-së me datë 28.12.2016. Qeveria e Malit të Zi në mbledhjen e mbajtur me 16.02.2017 ka miratuar Vendimin për sjelljen e PHU-së të Komunës së Ulqinit. Me këtë përfundoi procesi i përpilimit dhe sjelljes së këtij dokumenti shumë të rëndësishëm planifikues i cili zgjati prej vitit 2009. Duhet theksuar se Ulqini është e vetmja komunë në Mal të Zi të cilës këtë dokument planifikues ja ka përpiluar pushteti qendror, gjegjësisht Qeveria.

Në bazë të Ligjit për rregullim hapësinor dhe ndërtim të objekteve me Plani hapësinor – urbanistik të vetëqeverisjes lokale përcaktohen qëllimet dhe masat e zhvillimit hapësinor dhe urbanistik të vetëqeverisjes lokale, në pajtim me zhvillimin e planifikuar ekonomik, social, ekologjik dhe kulturo – histori dhe sjellja e tij është e detyrueshme.

Në bazë të këtij Ligji, përveç PHU-së, dokumente lokale planifikuese janë edhe Plani detaj urbanistik (PDU), projekti urbanistik (PHU) dhe studimi lokal i lokacionit (SLL).

Kuvendi komunal i Ulqinit në fund të vitit 2014 ka miratuar dy Ndryshime dhe plotësime (NP) të Planeve detaje urbanistike, dhe atë për lokalitetet **„Fusha e Ulqinit“** dhe **„Ulqin – qytet“.** Këto dokumente planifikuese janë të vetmit të këtij lloji të cilët janë sjell gjatë kohëzgjatjes së Planit lokal të veprimit për luftë kundër korrupsionit (2014 - 2015).

Gjatë vitit 2016 janë miratuar Ndryshimet dhe plotësimet për lokalitetet **„Fusha e Ulqinit“** dhe **„Ulqin - qytet“,** NP për parcela të caktuara urbanistike dhe kadastrale në zonën përfshirëse të PDU-së **„Ulqin - qytet“** për lokalitetin **„Pinjesh 1“,** si dhe PDU për lokalitetin **„Kodre 1“.**

Me Planin detaj – urbanistik përcaktohen kushtet për ndërtimin e objekteve në vendbanimet në zonën e planit hapësinor – urbanistik në mënyrë e cila siguron zbatimin e këtyre planeve. Plani

detaj urbanistik sillet detyrimisht për të gjithë vendbanimet ose pjesët e vendbanimeve për të cilët është e paraparë një gjë e tillë me planin hapësinor – urbanistik të vetëqeverisjes lokale.

Me PHU-në e Komunës së Ulqinit është paraparë ekzistimi i PDU-së për 22 lokalitete. Në bazë të udhëzimeve nga ky dokument planifikues, për 9 PDU-të ekzistuese nevojitet përpilimi i revizionit, për 4 lokalitete mbesin planet ekzistuese, ndërsa për 9 zona nevojitet përpilimi i dokumenteve të reja planifikuese të këtij lloji.

Poashtu, me PHU janë paraparë projektet urbanistike për lokalitetet Kalaja, Rana, Hotel Mediteran, Hotel Galeb, Kalaja e Shasit dhe Qendra e re e Ulqinit. Mirëpo, gjatë viteve 2014, 2015 dhe 2016 nuk është miratuar asnjë projekt urbanistik në territorin e Komunës së Ulqinit. Me Planin hapësinor – urbanistik janë paraparë zgjidhjet e reja planifikuese për lokalitetet Kalaja, Kalaja e Shasit dhe Qendra e re e Ulqinit, si dhe revizioni i planeve ekzistuese të këtij lloji për lokalitetet Rana, Hotel Mediteran dhe Hotel Galeb.

Sa i përket studimeve lokale të lokacionit, gjatë viteve 2014, 2015 dhe 2016 janë miratuar dy, dhe atë për lokalitetet „Bashbylyk“ dhe „Oliva Park“ në Lima, të cilët Kuvendi komunal i Ulqinit i ka miratuar me 17.02.2014. Me PHU janë paraparë 24 studime lokale të lokacionit për territorin e komunës së Ulqinit, gjersa me të njëjtin plan është përcaktuar revizioni i 7 SLL-ve ekzistuese, përpilimi i 15 planeve të reja të këtij lloji, gjersa për dy lokalitete do të mbesin në fuqi planet ekzistuese. Është interesante që është paraparë edhe revizioni i planit „Bashbylyk“, edhe pse ky dokument planifikues u miratua në fund të vitit 2014.

Masa e dytë e Planit të veprimit **parasheh identifikimin e problemeve në zbatimin e Ligjeve dhe rregullave të tjera nga fusha e rregullimit hapësinor dhe ndërtim të objekteve**, ndërsa indikatorët e rezultateve të arritura janë numri dhe lloji i mbledhjeve të mbajtura me qëllim zgjidhjen e problemeve, numri dhe lloji i analizave, raporteve dhe materialeve të tjera profesionale të përpiluara për gjendjen e rregullimit hapësinor dhe ndërtimin e objekteve, si dhe numri dhe lloji i vendimeve të miratuara për tejkalimin e problemeve të identifikuara.

Me **masën e tretë** është paraparë **përcaktimi i gjendjes në hapësirë dhe ndërmarrja e aktiviteteve përgatitëse për zbatimin e Ligjit për legalizimin e objekteve informale**. Indikatorët e rezultateve të arritura për këtë masë janë Raporti për gjendjen në hapësirë për objektet e ndërtuara pa leje, analiza e aktiviteteve me afate dhe bartësit e aktiviteteve në zbatimin

e Ligjit për legalizimin e objekteve informale, analiza e përpiluar, raportet e përpiluara për situatën në terren në pajtim me zbatimin e dokumentacionit planifikues, si dhe sjellja e planit të brendshëm të trajnimi të të punësuarve për zbatimin e Ligjit për legalizimin e objekteve informale.

Sipas Ligjit ekzistues për rregullim hapësinor dhe ndërtim të objekteve organi i vetëqeverisjes lokale ka detyrim që kuvendit të vetëqeverisjes lokale një herë në vit t'ja dorëzojë raportin për gjendjen e hapësirës. Poashtu, sipas të njëjtit Ligj, kuvendi i vetëqeverisjes lokale një herë në vit miraton programin njëvjeçar të rregullimit hapësinor.

Kuvendi komunal i Ulqinit i miratoi Raportet për rregullim hapësinor për vitet 2014, 2015 dhe 2016. Duhet theksuar se raporti për vitin 2015 është miratuar me 27.04.2016, edhe pse, për shkak të lidhshmërisë me dokumentet tjera të rëndësishme komunale (programin e rregullimit hapësinor, buxhetin e vetëqeverisjes lokale), është praktikë që kjo që të bëhet në prag të përfundimit të vitit kalendarik.

Analiza e gjendjes së rregullimit hapësinor dhe ndërtim të objekteve, përpilimi i së cilës është një nga indikatorët e realizimit të masës së dytë nga PV për luftë kundër korrupsionit në Komunë të Ulqinit, është pjesë përbërëse e Raportit për rregullim hapësinor.

Komuna e Ulqinit ka bërë analizën e gjendjes në terren për vitet 2014, 2015 dhe 2016, me të dhënat përkatëse për llojet e objekteve, paraqitjen horizontale dhe vertikale të hapësirës me objekte, **vetëm për lokalitetet ku ekziston dokumentacioni planifikues (PDU, SLL, SDL, PU).** Raportet për gjendjen në terren në pajtim me zbatimin e dokumentacionit planifikues, përpilimi i të cilëve është një nga indikatorët e realizimit të masës së tretë të Planit të veprimit për luftë kundër korrupsionit, sipas përgjigjes të cilën na e dhanë nga Sekretariati për rregullim hapësinor dhe zhvillim të qëndrueshëm, janë të përpiluara dhe janë pjesë përbërëse e Raporteve për rregullim hapësinor për vitet 2014, 2015 dhe 2016.

Parlamenti komunal ka miratuar edhe Programin e rregullimit hapësinor për vitet 2014, 2015 dhe 2016.

Sekretariati për rregullim hapësinor dhe zhvillim të qëndrueshëm gjatë viteve 2014, 2015 dhe 2016 ka mbajtur takime të brendshme çdo muaj të cilët kishin për qëllim zgjidhjen e problemeve të përcaktuara në fushën e rregullimit hapësinor dhe ndërtim të objekteve.

Mirëpo, në periudhën e vlefshmërisë së Planit të veprimit (2014 - 2015), ky Sekretariat solli vetëm një vendim me qëllim të tejkalimit të problemeve të identifikuara për gjendjen e rregullimit hapësinor dhe ndërtim të objekteve. Bëhet fjalë për Vendimin për ndërtimin e objekteve lokale me interes të përgjithshëm, i cili u publikua në Fletën zyrtare të Malit të Zi – Dispozitat komunale, nr. 21/14.

Gjatë vitit 2016 i njëjti Sekretariat solli tre vendime të këtij lloji dhe atë: Vendimin për ndërtimin dhe heqjen e objekteve të karakterit montazh në territorin e Komunës së Ulqinit, Vendimin për objektet ndihmëse në territorin e Komunës së Ulqinit, si dhe Vendimin për vendosjen, gjegjësisht ndërtimin dhe heqjen e rampave dhe ashensorëve qasës, si dhe objekteve të ngjashme për qasje dhe lëvizje të personave me lëvizshmëri të zvogëluar dhe personave me invaliditet në territorin e komunës së Ulqinit.

Edhe pse me Plan të veprimit për luftë kundër korrupsionit ishte e paraparë që Komuna e Ulqinit, gjatë vitit 2014 dhe 2015, të ndërmarrë aktivitetet për zbatimin e Ligjit për legalizimin e objekteve të përkohshme, Sekretariati për veprimtari komunale dhe mbrojtje të ambientit, në përgjigjen e dërguar në kërkesën tonë për qasje të lirë të informatave, ka konstatuar që kjo vetëqeverisje lokale nuk ka ndërmarrë aktivitete për zbatim më të mirë të ligjit.

Në ndërkohë, Kuvendi i Malit të Zi ka miratuar Ligjin për regulizimin e objekteve informale, i cili hyri në fuqi me 31.08.2016, ndërsa zbatimi i të cilit duhet të fillonte me 01.03.2017.

Mirëpo, Qeveria ka përcaktuar Propozimin e ndryshimeve të Ligjit për regularizimin e objekteve informale me të cilët është paraparë që zbatimi i Ligjit të shtyhet deri me 31.07.2017, në mënyrë që të plotësohen kushtet teknike.

Me këtë Ligj, përveç të tjerash, është përcaktuar që evidencën e objekteve informale për legalizimin e të cilëve janë kompetent organet e vetëqeverisjes lokale e menaxhojnë dhe e përditësojnë këto organe, gjersa organi i administratës i cili është kompetent për regjistrimin e të

drejtave në kadastër të patundshmërive është i detyruar të bëjë harmonizimin e orto – foto xhirimeve në territorin e Malit të Zi me shtresat digjitale dhe ti bëjë të qasshme nëpërmjet faqes së internetit – Geoportalit, organeve kompetente të administratës lokale dhe Ministrisë, me të dhënat të cilat i disponon.

Sekretariat për veprimtari komunale dhe mbrojtje të ambientit e Komunës së Ulqinit me ndryshimet dhe plotësimet e Rregullores për sistemazimin e vendeve të punës, përveç kuadrove ekzistuese, do të parashoh edhe pranimin e punonjësve të profilit të duhur, për të plotësuar kushtet për zbatimin e Ligjit për rregularizimin e objekteve informale.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit për regularizimin e objekteve informale Ligji për legalizimin e objekteve të përkohshme nuk vlen më. Mirëpo, në kërkesën tonë nr. 15/17 nga data 03.02.2017, me të cilën nga Sekretariati për planifikim hapësinor dhe zhvillim të qëndrueshëm kemi kërkuar informatën se a është sjell Plani i trajnimit të brendshëm për të punësuarit në këtë sekretariat me qëllim përgatitjet për implementimin e Ligjit për legalizimin e objekteve informale, gjë që ishte e planifikuar me Planin e veprimit për luftë kundër korrupsionit, me vendimin nr. 05-45/17 të datës 16.02.2017 fituam përgjigjen se **plani i brendshëm është akoma në fazën e përpilimit!**

Masa e katërt dhe e pestë e Planit të veprimit për luftë kundër korrupsionit në Komunë të Ulqinit parashohin **vendosjen e funksionimit të një sporteli sipas lëmive nga kompetenca e Komunës dhe përmirësimi i infrastrukturës së përgjithshme me qëllim të zbatimit të sistemit informativ të Komunës.**

Strategjia e reformës së administratës publike në Mal të Zi 2011 – 2016 (AURUM) zhvillimin e e-administratës e ka nënvizuar si prioritet për të gjithë njësitë e administratës lokale. Dokumenti kryesor në fushën e zhvillimit të administratës elektronike në nivel lokal duhet të jenë programet e zhvillimit të administratës elektronike në vetëqeverisje lokale. Këto programe duhet të paraqesin pasqyrimin e aktiviteteve dhe masave për promovimin e ICT-së në nivel lokal dhe zbatimin efikas të Strategjisë së zhvillimit të shoqërisë informative në Mal të Zi për periudhën 2009-2013.

Me këtë Strategji është përcaktuar që qëllimi kryesor i e-administratës të jetë përmirësimi në ofrimin e shërbimeve publike, rritja e pjesëmarrjes demokratike dhe kyçja e opinionit në procesin e sjelljes së vendimeve dhe krijimin e politikave.

Komuna e Ulqinit nga mesi i vitit 2013 në kuadër të projektit „Themelimi i Byrosë qytetare dhe i administratës elektronike“ ka futur zgjidhjen softuerike e cila mundëson funksionimin e një sporteli sipas fushave nga kompetenca e vetëqeverisjes lokale, e cila zyrtarisht ka filluar të punojë me 01.01.2014.

Në Byronë qytetare të Komunës së Ulqinit ekzistojnë 7 sportele, duke përfshirë edhe sportelin e ri i cili është shtuar gjatë vitit 2016, në të cilët janë organet e përmendura të vetëqeverisjes lokale, si dhe sporteli i postës ku mund të kryhen pagesat.

Ky sistem paraqet themelin e administratës bashkëkohore, e cila ka për qëllim efikasitetin, transparencën dhe qasjen më të thjeshtë qytetarëve.

Në kuadër të këtij sistemi ekzistojnë zgjidhjet modulare për kompetencat e caktuara të disa organeve të Komunës së Ulqinit.

Qendra për sistem informativ e Komunës së Ulqinit në periudhën e kaluar ka realizuar një sërë aktivitetesh për përmirësimin e e-administratës në këtë vetëqeverisje lokale dhe atë: ndryshimin gradual të pajisjeve të vjetra kompjuterike me të rejat (tre tenderë, dy donacione), implementimin e softuerëve për administratë elektronike, përmirësimin dhe implementimin e sistemit të sigurisë, si dhe integrimin e sistemit për të ardhurat lokale në sistemin e ri informativ.

Komuna e Ulqinit në mënyrë periodike ka organizuar trajnimet për të punësuarit në shfrytëzimin e zgjidhjeve softuerike për funksionimin e një sporteli sipas lëmive nga kompetenca e vetëqeverisjes lokale, gjë që ishte edhe një nga indikatorët e rezultateve të arritura në realizimin e masës së katërt nga Plani i veprimit. Qendra për sistem informativ ka organizuar me 11.04.2016 prezantimin me temë „Zgjidhjet softuerike për avancimin e punës më efikase të administratës lokale“, në të cilin morën pjesë përfaqësuesit e Kabinetit të Kryetarit të Komunës, si dhe i të gjithë sekretariateve dhe shërbimeve të kësaj vetëqeverisje lokale.

Me **masë të gjashtë** të Planit të veprimit për luftë kundër korrupsionit në Komunë të Ulqinit, si dhe me indikatorët e rezultateve të arritura nga masa e katër e këtij Plan të veprimi është paraparë **ndërmarrja e aktiviteteve për përcaktimin e ekzistencës së biznes barrierave në lëmit që janë kompetencë e Komunës** dhe eliminimin e tyre duke shfrytëzuar, përveç të tjerash, sistemet e përmirësuara informatike për punën e sporteleve nga lëmit me rëndësi për zhvillimin e sipërmarrjes dhe heqjen e biznes barrierave.

Përmirësimi i qasjes së qytetarëve në e-administratën në nivelin lokal të administrimit është përcaktuar si prioritet me Strategjinë e zhvillimit informatikë të shoqërisë deri në vitin 2013. Me këtë strategji është planifikuar standardizimi i ndërfaqes (interfejsit) dhe portalit për qytetarë në mënyrën „one stop shop“ (të gjitha në një vend).

Komuna e Ulqinit nuk e ka bërë analizën e dispozitave komunale, por, në pajtim me ndryshimet e ligjit dhe në bashkëpunim me qytetarët, sipërmarrësit dhe shoqëritë e biznesit, ka shqyrtuar disa dispozita për të cilët ka përcaktuar që paraqesin barrierë.

Si rezultat i kësaj, u ndryshua vendimi për anëtarësinë në organizatat turistike.

Poashtu, u thjeshtua procedura sepse të gjithë informatat dhe nxjerrja e dokumenteve, vendimeve, mund të kryhen në Byronë e qytetarëve. Me sistemin e ri çdo i punësuar ka qasje në rrjedhën e lëndës dhe fiton njoftimin nëse lënda nuk është zgjidhur.

Masa e shtatë nga Plani i veprimit për luftë kundër korrupsionit në Komunë të Ulqinit parasheh **sigurimin e qasjes së lirë të informatave**.

Me vendimin për organizimin dhe mënyrën e punës së organeve të vetëqeverisjes lokale është paraparë që çdo sekretariat, shërbim i veçantë dhe profesional në Komunë të Ulqinit të kryejë punët lidhur me qasjen e lirë të informatave nga fushëveprimi i tyre, e të cilët janë të parapara me Ligjin për qasje të lirë të informatave.

Poashtu, Komuna e Ulqinit ka përpiluar, publikuar në faqen e vet dhe bënë përditësimin e rregullt të Udhërrëfyesit për qasje të informatave në pronësi të vet.

Trajnimi i punonjësve të Komunës së Ulqinit për zbatimin e Ligjit për qasje të lirë të informatave u organizua me 26.09.2013, në hapësirat e Komunës së Ulqinit. Nga Sekretariati për administratë

dhe veprimtari shoqërore na kanë kufizuar informatën rreth numrit të punonjësve të trajnuar të Komunës së Ulqinit për zbatimin e Ligjit për qasje të lirë të informatave për arsye se kjo informatë nuk ishte në pronësi të këtij sekretariati.

Edhe pse me indikatorët e rezultateve të arritura në zbatimin e masave nga PV për luftë kundër korrupsionit ishte e paraparë ekzistenca e vendimeve të dhëna për qasje të lirë të informatave gjatë vitit 2014 dhe 2015, si dhe përpilimi i raporteve të organeve të vetëqeverisjes lokale të Komunës së Ulqinit për zbatimin e Ligjit për qasje të lirë të informatave, kjo nuk është bërë.

Nga Shërbimi i Kryeadministratorit poashtu na kanë thënë se ky organ as gjatë vitit 2016 nuk e ka përpiluar raportin për zbatimin e Ligjit për qasje të lirë të informatave dhe se ato, kur dorëzohen kërkesat për qasje të lirë të informatave, respektojnë në mënyrë strikte dispozitat e ligjit të përmendur.

Me kërkesat tona për qasje të lirë të informatave nr. 26 dhe 27/17 kemi kërkuar qasje të informatave për numrin e ankesave dhe padive gjatë viteve 2014, 2015 dhe 2016 për shkak të heshtjes së administratës, gjegjësisht për shkak të mosrespektimit të Ligjit për qasje të lirë të informatave. Kryeadministratori i Komunës së Ulqinit, me shkresat nr. 14-18/1-2017 dhe 14-19/1-2017, na u përgjigj që "gjatë viteve 2014, 2015 dhe 2016 nuk është deklaruar asnjë ankesë, e as nuk është dorëzuar asnjë padi për shkak të heshtjes së administratës...".

Mirëpo, mbas hulumtimit tonë të mëtejshëm, kemi vërtetuar se kjo informatë është e pasaktë dhe se kërkesa të tilla, gjegjësisht ankesa dhe padi, kishte mbi 80, duke përfshirë edhe 8 padi, gjersa numri më i madh i ankesave/ankesave të përsëritura ishin bërë për shkak të "heshtjes" së Kabinetit të kryetarit dhe Sekretariatit për buxhet dhe financa.

Masa e tetë nga PV për luftë kundër korrupsionit në Komunë të Ulqinit për periudhën 2014-2015 parasheh **Informimin e shfrytëzuesve për llojet e shërbimeve të cilat i ofron Komuna**.

Me kërkesat numër 30, 31 dhe 32/17 kemi kërkuar qasje të informatave për realizimin e indikatorëve të rezultateve të arritura të kësaj mase nga Sekretariati për administratë dhe veprimtari shoqërore. Këto indikatorë, në mes tjerash, kanë paraparë udhërrëfyesin e punuar dhe përpiluar për shfrytëzuesit, numrin e udhërrëfyesve të shpërndarë, si dhe numrin e vendeve në të

cilët ato do të shpërndahen. Nga ky sekretarit na kanë kufizuar qasjen e këtyre informatave, sepse këto informata, siç thanë ato, nuk janë në pronësi të këtij resori komunal.

Në kuadër të masës së tetë të Planit të veprimit po ashtu është paraparë mbajtja e takimeve të përbashkëta për sjelljen e rregullave të reja dhe ndryshimet dhe plotësimet e rregullave ekzistuese me qëllim thjeshtëzimin e procedurave administrative në Komunë të Ulqinit, si dhe miratimin e tyre. Mirëpo, nga Shërbimi i Kryeadministratorit na janë përgjigjur që asnjë takim nuk u mbajt gjatë viteve 2014, 2015 dhe 2016, për arsye se, sipas vlerësimit të tyre, organizimi i takimeve nuk ishte i nevojshëm meqë ligjet zbatohen pa vështirësi.

Me **masën e nëntë** është paraparë **përmirësimi i komunikimit në mes të organeve kompetente të administratës lokale dhe shërbimeve publike dhe qytetarëve,** si dhe **sigurimi që shfrytëzuesit e shërbimeve të fitojnë çdo lloj informate, të dorëzojnë kërkesat dhe të fitojnë aktet administrative dhe të tjera në një vend.**

Siç e kemi përmendur tashmë, Komuna e Ulqinit që në vitin 2013 ka filluar implementimin e sistemit softuerik dhe me këtë ka kontribuar në përmirësimin e komunikimit në mes të organeve kompetente të administratës lokale dhe të qytetarëve.

Mirëpo, edhe pse ishte e paraparë me indikatorët e rezultateve të arritura nga PV, Komuna e Ulqinit nuk ka vendosur linjën telefonike për dhënien e informatave dhe lajmërimin e parregullsive në punën e organeve, punonjësve dhe zyrtarëve nga ana e qytetarëve.

Përveç linjës telefonike, Komuna e Ulqinit, gjatë viteve 2014, 2015 dhe 2016, nuk ka vendosur asnjë mekanizëm të ri për dorëzimin e padive dhe ankesave të qytetarëve në punën e organeve dhe shërbimeve.

Me **masën e dhjetë** të Planit të veprimit për luftë kundër korrupsionit në Komunë të Ulqinit është paraparë **përmirësimi i komunikimit në mes të organeve të vetëqeverisjes lokale dhe organeve lokale kompetente dhe shërbimeve publike**.

Kabineti i kryetarit të Komunës së Ulqinit gjatë vitit 2014 iu drejtua organeve të administratës shtetërore 85 herë, gjatë vitit 2015 102 herë, ndërsa 68 herë gjatë vitit 2016. Duhet theksuar se kjo informatë ka të bëjë vetëm me Kabinetin e kryetarit, sepse siç na u përgjigjen me Vendimin numër UP I 01-52-17, ato nuk posedojnë informatat për numrin e komunikimeve të organeve

tjera lokale dhe shërbimeve publike, sepse nuk ekziston evidenca unike, gjegjësisht secili nga organet e përmendura drejton evidencë të veçantë.

Organizimi i trajnimit për të punësuarit në temën e zbatimit të Kodeksit etik në vetëqeverisjen lokale, lufta kundër korrupsionit në nivel lokal është **masa e njëmbëdhjetë** e Planit të veprimit për luftë kundër korrupsionit.

Edhe pse gjatë kohëzgjatjes së Planit të veprimit (2014-2015) ishte e planifikuar sjellja e planit të trajnimit, realizimi i trajnimeve dhe përpilimi i raporteve nga këto trajnime, kjo nuk është bërë.

Me vendimin nr. 03-111/17 nga Sekretariati për administratë dhe veprimtari shoqërore na janë përgjigjur që Komuna e Ulqinit nuk e ka sjell planin e trajnimit të të punësuarve në temën e zbatimit të Kodeksit etikë në vetëqeverisjen lokale dhe luftën kundër korrupsionit në nivel lokal. Nga ky Sekretariat po ashtu na kanë thënë se gjatë periudhës së njëjtë kohore, nuk kanë informatë për numrin e trajnimeve të realizuara në këto tema për të punësuarit në këtë vetëqeverisje lokale. Meqë me Vendimin për organizimin dhe mënyrën e punës së Komunës së Ulqinit është paraparë që Sekretariati për administratë dhe veprimtari shoqërore, përveç të tjerash, të punojë edhe në „përgatitjen e propozimeve të programit të aftësimit profesional të kuadrove dhe praktikantëve, të shikojnë dhe analizojnë nevojat e organeve për aftësim dhe trajnim të kuadrove dhe dhënien e ndihmës në realizimin e trajnimit dhe aftësimit të kuadrove, koordinimin e aktiviteteve rreth trajnimit të të punësuarve...“, mosposedimi i këtyre informatave nga ky resor me shumë mundësi do të thotë që asnjë trajnim në këto tema nuk është bërë gjatë periudhës së kërkuar. Mosekzistenca e planit të trajnimit, si dhe mosrealizimi i trajnimeve si rezultat kishte mosekzistencën e raportit për zbatimin e planit të trajnimit, i cili poashtu ishte një nga indikatorët e rezultateve të arritura të kësaj mase nga Plani i veprimit.

Duhet theksuar se Komuna e Ulqinit nuk e ka përpiluar as Planin e zhvillimit personal për të punësuarit në këtë vetëqeverisje lokale, edhe pse me Plan strategjik të kësaj vetëqeverisje lokale, në analizën e kapaciteteve administrative, si dobësi janë shënuar „potencialet njerëzore pamjaftueshëm të kualifikuara, veçanërisht në kuptimin e dijeve dhe aftësive specifike, si dhe dija e pamjaftueshme informatike dhe e gjuhëve të huaja“.

Masa e dymbëdhjetë e Planit të veprimit ka paraparë **organizimin e trajnimeve për përpilimin dhe menaxhimin e projekteve të cilët financohen nga ana e institucioneve dhe organizatave ndërkombëtare.**

Me Rregulloren për organizim dhe sistematizim të vendeve të punës të Kabinetit të kryetarit të Komunës së Ulqinit është formuar Departamenti për marrëdhënie ndërkombëtare dhe fonde të Bashkimit europian, por, deri tani, nuk u plotësuan vendet e punës të cilët janë paraparë me këtë rregullore. Sipas Vendimit numër 01 – 215/17 të Kabinetit të kryetarit të Komunës së Ulqinit, anëtarët e këtij departamenti momentalisht angazhohen sipas nevojës në projektet e aprovuara – sipas PRAGU-të, në konsultim me nivelin e parë të kontrollit të Ministrisë së financave (CFCU) dhe Delegacionin e Bashkimit europian.

Këtij departamenti në vitin 2013 i është dorëzuar mirënjohja „Praktika më e mirë në vetëqeverisjen lokale në Mal të Zi në vitin 2013“ për fushën tematike „Përgatitja dhe zbatimi i projekteve të financuara nga BE fondet“, të cilën e japin Bashkësia e Komunave të Malit të Zi, Ministria e punëve të brendshme dhe misioni OSBE-së në Mal të Zi.

Skuadra momentale ka eksperiencë shumëvjeçare në implementimin e projekteve të BE-së, ndërsa me qëllim të aftësimit dhe përmirësimit të punonjësve të angazhuar, Komuna e Ulqinit iu mundëson ndjekjen e seminareve, trajnimeve dhe punëtorive të ndryshme, të cilat organizohen në kuadër të programeve të caktuara, gjegjësisht nga ana e organizatave të caktuara ndërkombëtare.

Gjatë viteve 2014 dhe 2015 të punësuarit në këtë zyrë kanë marrë pjesë në shumë trajnime me këtë tematikë.

- Marketingu dhe brendimi në turizëm, 2014
- Training on local development and investment promotion, 2015
- Fondet e hapura të BE-së për Komunat malazeze, 2014
- Përpilimi dhe menaxhimi i BE projekteve, 2015

Poashtu, gjatë vitit 2016 përfaqësuesit e këtij departamenti ishin pjesëmarrës të workshop-it në kuadër të programit IPA CBC Mali i Zi – Shqipëri, gjersa në vitin 2017, përveç të tjerash, kanë

marrë pjesë edhe në prezantimin e projektit me temë "Programi rajonal i forcimit të demokracisë lokale në Ballkanin perëndimor (ReLOaD)".

Sistemi i vendosur i vlerësimit të rezultateve të punës dhe sistemi i avancimit dhe shpërblimit në bazë të rezultateve është **masa e trembëdhjetë** nga Plani i veprimit për luftë kundër korrupsionit në Komunë të Ulqinit për periudhën 2014 – 2015.

Me vendim numër 03-114/2017 të Sekretariatit për administratë dhe veprimtari shoqërore na janë përgjigjur që, mbas shikimit të dokumentacionit të kërkuar, është vërtetuar që Komuna e Ulqinit nuk ka vendosur sistemin e vlerësimit të rezultateve të punës të të punësuarve, e as sistemin e avancimit dhe shpërblimit të tyre në bazë të rezultateve të punës.

Mirëpo, me vendimin numër 03-72, 73, 74/2017-1 të të njëjtin resor komunal na janë përgjigjur që vetëqeverisja lokale posedon vendimet për vlerësimin e rezultateve të punës për të punësuarit për vitet 2014, 2015 dhe 2016 dhe ato na janë dorëzuar në formë elektronike, edhe pse nuk ekziston sistemi i përcaktuar i vlerësimit të rezultateve të punës të punëtorëve.

Indikatorët tjerë të rezultateve të arritura për këtë masë, siç janë: raportet për avancimin e të punësuarve, numri i punëtorëve të shpërblyer dhe vlera e mjeteve financiare të dhëna për shpërblime, nuk na janë dorëzuar.

Një nga fushat më vitale në luftë kundër korrupsionit, e cila është përcaktuar në kuadër të Planit lokal të veprimit për luftë kundër korrupsionit është ajo e punësimit. Siç thuhet në Planin e veprimit, „**ekzistenca dhe zbatimi i procedurave publike për punësimin në vetëqeverisje lokale dhe angazhimi i personave kompetent për kryerjen e punëve nga kompetenca e Komunës"** është **masa e katërmbëdhjetë** për arritjen e qëllimit strategjik i cili tenton të **„rrisë shkallën e përgjegjësisë dhe profesionalizimit të punës së vetëqeverisjes lokale**". Si aktivitete të cilat do të kontribuojnë në arritjen e kësaj mase numërohen: „zbatimi i rregullave ligjore për mënyrën e punësimit me shpallje publike" dhe „sjellja e rregullave të brendshme në nivel të Komunës për procedurat dhe kriteret e punësimit". Pra, një nga aktivitetet e propozuara nuk është implementuar aspak në bazë të përgjigjeve të fituara nga Komuna dhe Sekretariati kompetent. Kjo krijon dyshime të mëdha në qëllimin e Komunës që të kapet seriozisht me problemin e korrupsionit, meqë në luftë kundër korrupsionit që në fillim janë në gjysmë pune të (pa)kryer. Kur flasim për aktivitetin e parë, rregullat ligjore janë zbatuar, por janë shumë

kontestues. Ndoshta gabimi i cili ndodhi në masë, ku në vend të „kryerjes së punës“ shkruan „publikimi i punës“, tregon që konkurset e hapura vetëm formalisht kanë kënaqur kriteret e punësimit.

Komuna e Ulqinit nuk ka dorëzuar të dhënat për numrin e përgjithshëm e të punësuarve për vitet 2014, 2015 dhe 2016, që vërteton dyshimin tonë për keqpërdorimin e mundësisë së punësimit mbi cilëndo bazë ë Komunë dhe organet e saja udhëheqëse. Në bazë të sistematizimit të vendeve të punës, dokument i cili u dorëzua në bazë të kërkesës tonë, është shumë e vështirë të konkludohet cili është numri total i punëtorëve të nevojshëm për kryerjen e punëve brenda strukturave të caktuara të administratës lokale. Është edhe më e vështirë që në bazë të kësaj të konkludohet se a ishin disa punësime, në kohë të caktuar dhe të pacaktuar, me të vërtet të nevojshëm apo janë pjesë e kalkulimeve politike. Si një nga shembujt dyshues është punësimi i „ekspertëve - profesionistëve“ në kuadër të zyrës për shkrimin e projekteve, para së gjithash në periudhën e viteve 2014 – 2015, praktikë e cila vazhdojë edhe në fillim të vitit 2016. Është akoma më dyshues punësimi në këtë fushë nëse kemi parasysh rezultatin e të punësuarve brenda këtij segmenti të vetëqeverisjes lokale. Pra, ekzistojnë indicione të qarta që disa vende të punës janë hapur në mënyrë krejtësisht jotransparente, si dhe që përzgjedhja e kandidatëve është tejet dyshuese për shkak se kriteret e vendosura, konkursi, si dhe mënyra e nënshkrimit të Kontratave tregojnë për mundësinë e shkeljes së ligjeve dhe keqpërdorim të funksionit, me elemente të nepotizmit politik.

Pra, Neni 10 i Ligjit për zyrtarët dhe punonjësit nënvizon „disponibilitetin e njëjtë të vendeve të punës“, duke treguar se „Zyrtari shtetëror, gjegjësisht punonjësi inicion marrëdhënien e punës në bazë të shpalljes publike. Vendet e punës të zyrtarëve, gjegjësisht punonjësve shtetëror janë, nën kushte të njëjta, të disponueshme për të gjithë kandidatët. Gjatë përzgjedhjes së kandidatëve merren parasysh aftësia profesionale, dija, eksperienca e mëparshme, rezultatet e arritura në punë dhe rezultatet e arritura në procesin e kontrollit të detyrueshëm të aftësive“. Ekziston dyshimi se konkurset janë hapur vetëm për kandidatët e caktuar, meqë kryesisht kemi rastin që në një konkurs për një vend të punës lajmërohet vetëm një person. Po ashtu, mënyra e plotësimit të kritereve është i dyshimtë meqë nuk kishim qasje në tërë procesin e punësimit, gjegjësisht nuk u dorëzua komplet dokumentacioni për përzgjedhjen dhe mënyrën e zgjedhjes, raportet e komisionit, rezultatet e intervistës, mënyrën e evaluimit, etj.

Ekziston tendenca e qartë e Komunës së Ulqinit që opinionin ta mbajë larg nga informatat për punësimin në periudhën 2014 – 2016, meqë çdo përgjigje e tyre, gjegjësisht dokumentet të dorëzuara, janë të paqarta, nuk tregojnë për sistematizimin dhe/ose arkivimin adekuat të të dhënave për punësim. Të dhënat e dorëzuara janë të paplota dhe kryesisht të pasakta. Si ilustrim të kësaj do të përmendim që për informatën e kërkuar për numrin e të punësuarve në kohë të pacaktuar, dorëzohet dokumentacioni i cili përfshinë edhe kontratat në kohë të caktuar. Po ashtu, punonjësit nuk e kanë skedarin (dosjen) e tërë të punësimit të një personi, i cili përfshinë dokumentacionin prej hapjes së konkursit e deri tek nënshkrimi i kontratës, por vetëm dy dokumentet e fundit. Për periudhën 2014-2016, nga dokumentet e dorëzuara, ekzistojnë shtatë persona të punësuar në kohë të pacaktuar, por nuk ka mënyrë të evaluimit, dhe as dokumente (para së gjithash audio regjistrime) të cilët flasin për evaluimin e intervistës (në vitin 2014 një person, në 2015 katër, ndërsa në 2016 tre persona). Për Kontratat me kohë të pacaktuar, të cilat janë kërkuar nga Komuna, dorëzohet dokumentacioni për 22 kontrata me kohë të caktuar. Kemi edhe rastin kur praktikanti – vullnetari është paguar dhe kjo është e vërtetuar me kontratë. Në të gjitha këto konkurse është lajmëruar nga një kandidat për konkurs. Disa konkurse u hapen dhe pastaj u anuluan. Pastaj, ekziston kontrata e cila nënvizon marrëdhënien e përhershme të punës. Ka konkurse kontestuese të hapura në vitin 2015, e të mbyllura në vitin 2016, në të cilët janë lajmëruar dhe në të cilat pozita janë përzgjedhur njerëzit pa definim të qartë të mënyrës së evaluimit dhe përcaktim të qartë të kritereve profesionale. Duket tendenca e dukshme e komunës që pozitat „politike“ brenda komunës (siç janë sekretarët, menaxherët, këshilltarët dhe të ngjashme), të paraqiten si konkurse të hapura – transparente.

Është interesante të ceket që konkurset për vendet e lira publike publikohen në gazetat ditore „DAN“ dhe „Pobjeda“, gjersa kryesisht anulohen ato që publikohen në faqen e Entit për punësim.

Sekretariati për financa dhe buxhet prinë në nënshkrimin e kontratave mbi vepër (ose kontratave të ngjashme tipike). Mesatarisht janë nënshkruar rreth 30 kontrata në vit. Është karakteristike që nënshkruhen kontratat mbi vepër me personat të cilët janë tashmë të punësuar në administratën komunale. Sekretariati për planifikim hapësinor dhe urbanizëm, Sekretariati për ekonomi dhe zhvillim ekonomik, Sekretariati për mbrojtjen e pasurisë, si dhe Sekretariati për çështje banesore, nuk kanë nënshkruar asnjë kontratë mbi vepër në periudhën prej vitit 2014 deri në vitin 2016.

Sekretariati për veprimtari komunale ka punësuar vetëm një person. Qendra për sisteme informatike ka angazhuar për shërbime të caktuar 6 persona gjatë periudhës 2014-2016. Policia komunale nuk ka dorëzuar asnjë përgjigje në kërkesën për qasje të informatave, gjersa Shërbimi i kryeadministratorit ia ka përcjellë Sekretariatit për administratë dhe veprimtari shoqërore pyetjet e veta. Shërbimi i mbrojtjes dhe punëve të përbashkëta ka punësuar në këtë periudhë vetëm tre persona.

Sa i përket Kabinetit të kryetarit, ekziston indicioni i qartë që janë nënshkruar shumë kontrata të dyshimta dhe janë punësuar njerëzit jashtë sistematizimit dhe jashtë ligjit. Për shkak të mungesës së dokumentacionit të plotë, mund të thuhet se shumë kontrata të përbashkëta (punësime) janë nënshkruar me të njëjtit persona nga ana e Kabinetit të kryetarit dhe sekretariateve të caktuara. Po ashtu, nuk ka bazë për punësimin e personave të caktuar dhe nuk janë definuar dhe shpjeguar qartë procedurat e përzgjedhjes. Në kontratat e caktuara ekziston teprimi në shpjegimin e punës, nëse kemi parasysh që kontratat janë nënshkruar me njerëzit që nuk kanë shumë eksperiencë, dhe të cilët kishin kontrata të nënshkruara paraprakisht me Komunë të Ulqinit. Kualifikimet e personave të caktuar për pozita të fituara nuk janë të definuara qartë. Për shembull, nëse nevojitet dija e gjuhës malazeze dhe angleze për funksion/pozitë të caktuar, nuk thuhet si është definuar testimi i kandidatëve për aftësi gjuhësore.

Pastaj, kishte mjaft *Këshilltarë* për të cilët nuk ka prova për mënyrën e përzgjedhjes. Ekzistojnë kontratat të cilët tregojnë për pagesa të ndryshme për punë të njëjtë, gjersa në disa çmimet janë më të larta se ato të tregut. Përveç kësaj, ekzistojnë kontratat të cilat janë nënshkruar me personat nga administrata lokale për punët të cilët, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo, bëjnë pjesë në kompetencat e tyre në kuadër të detyrave ekzistuese që ato mbulojnë. Në rastet e furnizimit të komunës me prodhime të caktuara gjatë vizitës së delegacioneve të huaja, shihet tendenca e marrjes tej mase të artikujve me, ndoshta, ofertues të zgjedhur në mënyrë jotransparente. Duhet theksuar se ekzistojnë shumë gabime teknike në kontrata.

Në fund, ekzistojnë gjatë kësaj periudhe punësime të njerëzve pa kualifikime të nevojshme. Kjo ndikon në shpenzimet e komunës dhe në rezultatet e arritura. Si shembull mund të merret punësimi në Zyrën për shkrimin e projekteve, në të cilën në një moment ishin të punësuar mbi 10 veta, ku përshkrimi i punës nuk përputhet me kualifikimet e tyre dhe nuk ka përzgjedhje transparente të këtyre kandidatëve, veçanërisht jo në bazë të sistematizimit. Disa nga ato janë

rikualifikuar nga Zyra për shkrimin e projekteve në psh. Policinë komunale, gjersa, nga ana tjetër, rezultatet e zyrës ishin shumë më të mëdha me shumë më pak të punësuar.

Ajo çfarë brengos është fakti se organet kompetente të Komunës, gjatë përgjigjes në kërkesat për qasje të lirë të informatave, kanë luajtur lojën e „telefonit të shurdhër", meqë kanë përdorur dy kritere për përgjigje. Për shembull, Sekretariati për administratë dhe veprimtari shoqërore në modelin e njëjtë të pyetjes kanë dhënë përgjigje të ndryshme me qëllim të shmangies së dhënies së përgjigjes për punësim. Madje edhe të dhënat e dorëzuara nga ana e sekretariateve të ndryshme ishin të vonuara dhe kanë ndikuar në mundësinë e hulumtimit më të detajuar të politikës së punësimit në territorin e komunës së Ulqinit. Mungesa e dokumentacionit dhe pamundësia e hulumtimit të tërësishëm të kësaj fushe nuk ishte e mundur për shkak se nuk na është definuar qartë dallimi në mes të *kontratave mbi vepër* dhe *kontratave për punë të përkohshme*.

Masa e pesëmbëdhjetë nënkupton **„forcimin e përgjegjësisë së strukturës udhëheqëse dhe të të punësuarve",** por mund të themi se nuk është plotësuar sepse është e pamundur të vërtetojmë qartë treguesit e miratuar nga ana e strukturës udhëheqëse për sjelljen e zyrtarëve dhe punonjësve lokal, e akoma më vështirë është të shihen qëllimet e definuara qartë dhe rezultatet e pritura.

Motivimi i qytetarëve për pjesëmarrje aktive në procesin e përpilimit dhe miratimit të akteve, përcjelljen dhe kontrollin e punës së Komunës është masa e radhës nga PV për luftë kundër korrupsionit.

Numri i shqyrtimeve publike të mbajtura të organeve të vetëqeverisjes lokale me qëllim rritjen e shkallës së informimit të qytetarëve dhe transparenca e rritur në procesin e planifikimit, përcaktimit dhe përgatitjes së politikave lokale publike, si dhe raportet e hartuara nga këto shqyrtime publike janë vetëm disa nga indikatorët e rezultateve të arritura për këtë masë.

Sekretariati për veprimtari komunale dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor i Komunës së Ulqinit ka mbajtur shqyrtime publike për:

- Vendimi për rregullimin e komunikacionit në territorin e Komunës së Ulqinit,
- Vendimi për furnizimin publik me ujë,

- Vendimi për furnizimin me ujë të vendbanimeve rurale dhe të tjera në territorin e Komunës së Ulqinit,
- Vendimi për grumbullimin, pastrimin dhe derdhjen e ujërave të zeza në territorin e komunës së Ulqinit,
- Vendimi për grumbullimin dhe derdhjen e ujërave atmosferik në territorin e komunës së Ulqinit.

Mirëpo, raportet nga shqyrtimet publike për vendimet e përmendura vlejnë për vitin 2016 dhe jo për periudhën e vlefshmërisë së Planit të veprimit për luftë kundër korrupsionit, gjegjësisht vitin 2014 dhe 2015.

Vetëm për Draftin e Vendimit për rregullimin e komunikacionit në territorin e komunës së Ulqinit kishte vërejtje dhe atë në formë të shkruar (tre), gjersa pesë vërejtje janë dorëzuar nëpërmjet e-mailit. Gjithsej janë dorëzuar 14 propozime, prej të cilave përpunuesi i ka pranuar katër, gjersa të tjerët janë refuzuar, sepse nuk ishin në pajtim me Planin ekzistues për rregullim hapësinor.

Sekretariati për administratë dhe veprimtari shoqërore gjatë vitit 2014, 2015 dhe 2016 ka përgatitur dhe dhënë si propozim „rregullat komunale me të cilat përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e qytetarëve“ dhe atë:

- Vendimi për ndarjen e mjeteve OJQ-ve
- Planin lokal të veprimit për të rinj
- Planin lokal për antikorrupsion
- Planin lokal për barazi gjinore
- Planin lokal të veprimit për popullatën RAE
- Planin e integritetit

Me vendim nr. 03-296 dhe 298/17 të këtij resori komunal pohojnë se për „vendimin e përmendur dhe për planet lokale janë mbajtur shqyrtimet publike në të cilët interesimi i qytetarëve ishte i dobët, prandaj nuk janë përpiluar procesverbalet – raportet“,

Sekretariati për buxhet dhe financa gjatë periudhës së përmendur trevjeçare ka mbajtur shqyrtimet publike dhe ka hartuar raportet për Draftin e Vendimit për buxhet dhe Draftin e Vendimit për ndryshimet dhe plotësimet e Vendimit për buxhet të komunës së Ulqinit.

Sekretariati për ekonomi dhe zhvillim ekonomik, Sekretariati për veprimtari shoqërore, Qendra për sistem informatikë dhe Shërbimi për mbrojtje dhe punë të përbashkëta, gjatë periudhës së përmendur kohore, nuk kishin asnjë shqyrtim publik me qëllim rritjen e shkallës së informimit të qytetarëve dhe përmirësimin e transparencës në procesin e planifikimit, përcaktimit dhe përgatitjes së politikave lokale publike.

Nga Sekretariati për planifikim hapësinor dhe zhvillim të qëndrueshëm nuk kemi marr informatën e kërkuar, edhe pse Shërbimi i kryeadministratorit në mënyrë të rregullt ka kërkuar nga të gjithë sekretariatet dhe shërbimet e organit të vetëqeverisjes lokale të dhënat për këtë kërkesë.

Forcimi i vetëdijes së qytetarëve për rëndësinë e kontrollit qytetarë dhe përcaktimi dhe zbatimi i mekanizmave të rinj të pjesëmarrjes së qytetarëve është **masa e tetëmbëdhjetë** nga Plani i veprimit për luftë kundër korrupsionit në Komunë të Ulqinit.

Vizitat e punës në bashkësi lokale për të njohur nevojat e tyre është njëri nga indikatorët e rezultateve të arritura për realizimin e kësaj mase.

Sekretariati për veprimtari komunale dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor, Sekretariati për administratë dhe veprimtari shoqërore, Sekretariati për ekonomi dhe zhvillim ekonomik, Sekretariati për veprimtari banesore, Qendra për sistem informatikë dhe Shërbimi për mbrojtje dhe punë të përbashkëta, mbas kontrollit të dokumentacionit zyrtar kanë vërtetuar se gjatë viteve 2014, 2015 dhe 2016 nuk ishin në vizitë zyrtare në bashkësi lokale.

Sekretariati për buxhet dhe financa në këtë periudhë kohore ka mbajtur shqyrtimet publike për Draftin e buxhetit të Komunës së Ulqinit dhe atë në Bashkësitë lokale 1 dhe 2, për zonën e Anës së Malit në Katërkollë dhe në bashkësinë lokale Shtoj.

Masa e nëntëmbëdhjetë nga Plani i veprimit parasheh **organizimin e shqyrtimeve publike dhe tryezave të rrumbullakëta për draftet e ligjeve dhe aktet komunale me të cilat përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e qytetarëve**, gjersa **rritja e transparencës së punës së administratës lokale** është **masa e njëzet** e këtij plani.

Sekretariati për ekonomi dhe zhvillim ekonomik gjatë vitit 2014 kishte dy drafte të vendimeve të cilat Kuvendi i ka miratuar të njëjtin vit.

Drafti i Vendimit për komunikacionin në qytet dhe periferi dhe transportin me taxi – vetura u publikua në faqen e Komunës së Ulqinit. Shqyrtimi qendror publik u mbajt me 16.12.2014. Në këtë shqyrtim publik morën pjesë 12 taksistë, gjersa tema kryesore ishte ngjyra e taxi veturave.

Drafti i Vendimit për kushtet dhe mënyrën e emetimit dhe luajtjes së muzikës në objektet hotelerike dhe përcaktimi i rrugëve, pjesëve të rrugëve, vendbanimeve dhe lokaliteteve tjera për mbajtjen e tubimeve publike në të hapur, si dhe koha e mbajtjes, ishte në shqyrtim publik me 27.11.2014. Në Draftin e këtij vendimi nuk kishte ankesa.

Forcimi i rolit të bashkësive lokale është **masa e njëzet e një** e Planit të veprimit për luftë kundër korrupsionit në Komunë të Ulqinit.

Indikatorët e rezultateve të arritura janë, përveç të tjerash, formularët e hartuara të vendimeve dhe akteve tjera të cilët i miratojnë organet e bashkësive lokale.

Gjatë viteve 2013 dhe 2015 janë zgjedhur organet e reja të bashkësive lokale ekzistuese në pajtim me Vendimin për bashkësi lokale, për të cilët Kuvendi komunal i Ulqinit dha pëlqimin me vendimet e veta, të cilët u publikuan në „Fletën zyrtare të MZ“ – dispozitat komunale nr. 8/13, 37/13 dhe 6/15). Po ashtu, Komuna e Ulqinit ka mbuluar shpenzimet e regjistrimit të bashkësive lokale tek Enti për statistikë i Malit të Zi dhe shpenzimet e punimit të vulës për nevojat e bashkësive lokale.

Gjatë vitit 2013 u përzgjodhën organet e bashkësive lokale Bashkimi, Kravar, Krythë, Shtoj dhe Katërkollë, gjersa gjatë vitit 2015 u përzgjodhën organet e bashkësive lokale I dhe II, Brajshë, Darzë, Zogaj dhe Krruç.

Këtu duhet theksuar se Komuna e Ulqinit solli Vendimin për bashkësi lokale që në vitin 2011.

Afirmimi i institutit të karriges së lirë është **masa e njëzet e dytë** e Planit të veprimit për luftë kundër korrupsionit.

Kuvendi komunal i Ulqinit ka të vendosur *institutin e karriges së lirë* dhe ka evidencën e pjesëmarrjes së përfaqësuesve të sektorit OJQ në punën e Kuvendit.

Gjatë viteve 2014, 2015 dhe 2016 në punën e mbledhjeve kuvendore morën pjesë përfaqësuesit e OJQ-ve „Mogul“, „Hapi i gjelbër“, „Horizonti i ri“, „Dr. Martin Schneider Jacoby“ dhe „iACT“.

Me shfrytëzimin e „karriges së lirë“ përfaqësuesi i OJQ fiton të drejtën të flasë si këshilltarë dhe të drejtën për replikë, diskutimi regjistrohet në procesverbal, por nuk ka të drejtë vote, si dhe të drejtën të jetë i pranishëm në punën e pikave të tjera.

Forcimi i kontrollit të brendshëm dhe të jashtëm të punës së vetëqeverisjes lokale dhe vendosja e sistemit efikas dhe transparent të kontrollit të brendshëm të punës së organeve të administratës lokale është **masa e njëzet e tretë** e Planit të veprimit për luftë kundër korrupsionit.

Komuna e Ulqinit e ka vendosur revizionin e brendshëm duke organizuar njësit/shërbimet e veçanta organizative (Vendimi për organizim dhe mënyrën e punës së administratës lokale – „Fl. zyrtare e MZ“ – dispozitat komunale, nr. 16/12, 33/13, 13/14, 23/14, 11/15) dhe solli Rregulloren për organizim të brendshëm dhe sistematizim të vendeve të punës të Shërbimit për revizion të brendshëm numër 01-1010/17.

Shërbimi akoma nuk ka filluar të punojë sepse nuk u emëruar drejtuesi i Shërbimit, nuk ka punonjës të punësuar në shërbim, nuk janë kryer trajnimet dhe nuk ka pajisje teknike.

Masa e njëzet e katërt nga PV për luftë kundër korrupsionit në Komunë të Ulqinit parasheh **kryerjen e kontrollit buxhetor** nëpërmjet kryerjes së revizionit nga ana e institucionit të revizionit, përmirësimi i ueb faqes së Komunës, si dhe publikimin e dokumenteve, kontratave, vendimeve për dhënien e punëve, tenderëve, prokurimeve publike dhe lejeve të ndërtimit në portal.

Me vendim nr. 04-1873/17-2 të Sekretariatit për buxhet dhe financa na janë përgjigjur që është kryer revizioni nga ana e institucionit të revizionit për vitet buxhetore 2014 dhe 2015. Me të njëjtin vendim, të datës 10.05.2017, na është thënë se është në procesin e përpilimit revizioni për vitin 2016.

Përndryshe, me nenin 33 të Statutit të Komunës së Ulqinit është përcaktuar që, së bashku me llogarinë përfundimtare të buxhetit të Komunës, Kuvendit komunal të Ulqinit detyrimisht i dorëzohet edhe Raporti i revizionit ekstern.

Raportet e revizorëve nuk janë publikuar në faqen e Komunës së Ulqinit.

Qendra për sistem informatikë ka marrë nga organet kompetente dhe ka publikuar në ueb faqen e komunës këtë numër dokumentesh:

- Numri i kontratave: 559
- Numri i vendimeve: 75
- Numri i lajmërimeve për prokurime publike: 44
- Numri i lejeve të ndërtimit: 85

Të gjithë dokumentet e publikuara nga ana e Qendrës për sistem informatikë të Komunës së Ulqinit gjenden në adresën: http://www.ul-gov.me/Komuna-e-Ulqinit/108/Dokumente.shtml

Edhe pse me **masën e 25** të Planit të veprimit për luftë kundër korrupsionit në Komunë të Ulqinit ishte e paraparë **kryerja e kontrollit administrativ nga ana e organeve të vetëqeverisjes lokale ndaj punës së shërbimeve publike ku themelues është Komuna, ndërsa indikator i rezultateve të arritura ishte numri i raporteve të dorëzuara kryetarit të komunës,** kjo nuk ndodhi për arsye se raportet për punën e shërbimeve publike nuk i dorëzohen kryetarit të Komunës, siç është paraparë me Planin e veprimit, por Kuvendit komunal të Ulqinit e cila sipas Ligjit për vetëqeverisje lokale dhe Statutit të Komunës së Ulqinit kryen kontrollin ndaj punës së tyre.

Menaxhimi efikas dhe efektiv i prokurimeve publike është **masa e 26** e Planit të veprimit për luftë kundër korrupsionit në Komunë të Ulqinit (2014 - 2015). Indikatorët e rezultateve të arritura janë Raporti për analizën dhe revizionin e prokurimeve publike, nga aspekti i rrezikut nga korrupsioni.

Në pajtim me nenin 15 të Ligjit për prokurime publike është precizuar që:

Porositësi është i detyruar që të refuzojë ofertën nëse vërteton që ofertuesi në mënyrë direkte ose indirekte ka dhënë, ofruar ose shfaqur në pah dhuratën ose ndonjë përfitim tjetër zyrtarit për prokurime publike, anëtarit të komisionit për hapjen dhe vlerësimin e ofertave, personit i cili ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentacionit tenderik, personit i cili merr pjesë në planifikimin e prokurimit publik ose personit tjetër, me qëllim që të mësojë informata të besueshme ose të ndikojë në veprimin e porositësit.

Porositësi është i detyruar që të refuzojë ofertën nëse vërteton që ofertuesi në mënyrë direkte ose indirekte ka kërcënuar zyrtarin për prokurime publike, anëtarin e komisionit për hapjen dhe vlerësimin e ofertave, personin i cili ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentacionit tenderik, personin i cili merr pjesë në planifikimin e prokurimit publik ose personin tjetër, me qëllim që të mësojë informata të besueshme ose të ndikojë në veprimin e porositësit.

Porositësi është i detyruar që të evidentojë rastet nga pika 1 dhe 2 e këtij neni, për këtë të përpilojë shënimin zyrtar, të dorëzojë padinë para organeve kompetente shtetërore për ndërmarrjen e masave në pajtim me ligjin dhe të njoftojë organin kompetent.

Mënyra e menaxhimit dhe përmbajtja e evidencës nga pika 3 e këtij neni dhe metodologjia e analizës së rrezikut gjatë kryerjes së kontrollit, me qëllim të veprimit proaktiv në parandalimin dhe zbulimin e hershëm të punëve korruptive dhe veprave tjera me karakteristika të korrupsionit përcaktohen me rregulloren e organit të administratës shtetërore kompetent për punët e financave (në pjesën tjetër të tekstit Ministria).

Kontrata për prokurime publike e cila është nënshkruar me shkeljen e rregullave antikorruptive është e pavlefshme.

Kontrata për prokurime publike përmban dispozitën për pavlefshmërinë e kontratës në bazë të pikës 5 të këtij neni (klauzola antikorruptive).

Me vendim numër: 01-222/17 të Kabinetit të kryetarit të Komunës na janë përgjigjur që, gjatë vitit 2014, 2015 dhe 2016, nuk kishte raste të regjistruara të rregullave antikorruptive në prokurime publike, gjegjësisht raste të shkeljes së nenit 15 të Ligjit për prokurime publike.

Forcimi i rolit të Këshillit për zhvillim dhe mbrojtje të vetëqeverisjes lokale është **masa e 28** e Planit lokal të veprimit për luftë kundër korrupsionit në Komunë të Ulqinit.

Emërimi i Këshillit është indikatori i parë i suksesit të kësaj mase.

Mirëpo, me vendim numër 02-47-17-2 të Kuvendit komunal të Ulqinit jemi njoftuar se parlamenti lokal nuk e solli vendimin për emërimin e Këshillit për zhvillimin dhe mbrojtjen e vetëqeverisjes lokale.

Në bazë të këtij vendimi, trupi punues kompetent i Kuvendit ka iniciuar procesin e emërimit të anëtarëve të Këshillit dhe procedura është në vijim.

Këtu duhet theksuar se Këshilli për zgjedhje dhe emërime i Kuvendit komunal të Ulqinit ka shpallur thirrjen publike për propozimin e anëtarëve për këtë Këshillë në korrik të vitit 2014!

Edhe pse procedura e kandidimit të anëtarëve të Këshillit përfundoi që në gusht të po ati vit, deri me sot Këshilli për zgjedhje dhe emërime i Kuvendit komunal të Ulqinit për këtë gjë nuk ka vendosur.

Me nenin 145 të Ligjit për vetëqeverisje lokale është përcaktuar që Këshilli për zhvillim dhe mbrojtje të vetëqeverisjes lokale themelohet për realizimin e përmirësimit të vetëqeverisjes lokale. Anëtarët e Këshillit i përzgjedh Kuvendi komunal nga radhët e qytetarëve të theksuar dhe të respektuar të komunës dhe ekspertëve nga fushat me rëndësi për vetëqeverisje lokale.

Nga ana tjetër, sipas Statutit të Komunës së Ulqinit, gjegjësisht sipas nenit 191 të këtij dokumenti më të rëndësishëm komunal, Këshilli duhet të zgjidhet në afat 60 ditorë nga dita e konstituimit të Kuvendit dhe mandati i tij zgjat sa edhe ai i Kuvendit.

Në janar të vitit 2018 përfundon mandati i rregullt i Kuvendit komunal të Ulqinit. Edhe pse këtë gjë e parasheh Ligji për vetëqeverisje lokale, Statuti i Komunës së Ulqinit, por edhe Plani i veprimit për luftë kundër korrupsionit, Këshilli për mbrojtjen dhe zhvillimin e vetëqeverisjes lokale, tashmë pothuajse me siguri, nuk do të formohet deri në fund të mandatit.

Masa e 29 e Planit të veprimit për luftë kundër korrupsionit parasheh **miratimin e Planit të integritetit të Komunës së Ulqinit.**

Në bazë të Ligjit për parandalimin e korrupsionit, organet e pushtetit ishin të detyruar që të miratojnë Planin e integritetit deri me 31 mars të vitit 2016 dhe të ja dorëzojnë Agjencisë për parandalimin e korrupsionit 15 ditë nga dita e miratimit. Me Planin e veprimit për luftë kundër korrupsionit në Komunë të Ulqinit ishte e paraparë që Plani i integritetit i kësaj vetëqeverisje lokale të miratohet gjatë kohëzgjatjes së këtij Plani të veprimit, gjegjësisht jo më vonë se deri në fund të vitit 2015.

Përkundër dispozitave të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe masave nga Plani i veprimit për luftë kundër korrupsionit, Komuna e Ulqinit vetëm me datë 24.05.2016 solli Vendimin për formimin e Grupit punues për përgatitjen dhe përpilimin e planit të integritetit.

Detyra e grupit punues është që të përgatisë programin e përpilimit të planit të integritetit, të mbledh dhe analizojë dokumentacionin e nevojshëm i cili ka të bëjë me funksionimin e organeve të pushtetit, e i cili paraqet bazën për vlerësimin e rrezikut dhe përpilimin e planit të integritetit, të njoh të punësuarit me nevojën e sjelljes së planit të integritetit dhe të dorëzojë propozimin e hartuar të planit të integritetit udhëheqësit/personit përgjegjës në organin e qeverisjes për miratim.

Data e fillimit të hartimit të Planit të integritetit të Komunës së Ulqinit ishte 24.05.2016, ndërsa data e përfundimit të hartimit është 09.06.2016, gjersa data e miratimit të këtij dokumenti në Kuvendin e kësaj vetëqeverisje lokale ishte 10.06.2016.

Si na thanë me vendimin numër 01-227/17 dhe 230/17 nga Kabineti i kryetarit të Komunës, me qëllim të plotësimit të detyrimeve ligjore Komuna e Ulqinit ka përgatitur dhe miratuar Planin e integritetit në pajtim me Ligjin për parandalimin e korrupsionit dhe Rregullat për hartimin dhe zbatimin e planit të integritetit. Këto rregulla precizojnë procesin për hartimin dhe zbatimin e planit të integritetit.

Me Vendimin për miratimin e Planit të integritetit të Komunës së Ulqinit është paraparë që menaxheri i integritetit, të paktën një herë në vit, të dorëzojë raportin e shkruar për realizimin e këtij plani.

Me datë 06.04.2017, menaxheri i integritetit i Komunës së Ulqinit ka dorëzuar Kryetarit të komunës së Ulqinit raportin për zbatimin e planit të integritetit për periudhën raportuese qershor-dhjetor 2016.

Plani i integritetit i Komunës së Ulqinit ka gjithsej 79 masa për zvogëlimin e rrezikut prej të cilave 35 janë realizuar gjatë kësaj periudhe raportuese, 21 janë realizuar pjesërisht, gjersa 23 masa nuk janë realizuar.

Po ashtu, numri i përgjithshëm i rreziqeve reziduale në Planin e integritetit të Komunës së Ulqinit është 70, e në 10 prej tyre është zvogëluar rreziku gjatë periudhës raportuese.

Në hulumtimi të cilin OJQ „Ul info“ e ka realizuar nga 15 shkurti deri me 15 mars të vitit 2017, kur u anketuan 300 qytetare dhe qytetarë të rritur të komunës së Ulqinit, është vërtetuar se 65% e tyre nuk kanë dëgjuar dhe nuk dinë që Komuna e Ulqinit ka miratuar dhe se e zbaton Planin e integritetit, 20% ishin pa përgjigje, ndërsa vetëm 13,3% dinë diçka rreth kësaj teme.

Forcimi i integritetit të njësive të vetëqeverisjes lokale dhe zbatimi i standardeve etike në vetëqeverisjen lokale me afirmimin për vlerësim dhe/ose vetëvlerësim të zbatimit të standardeve të etikës publike është **masa e 30** e Planit të veprimit për luftë kundër korrupsionit të Komunës së Ulqinit (2014 - 2015).

Raporti për vlerësimin e zbatimit të standardeve të etikës publike, sjellja e Kodeksit etikë, miratimi i vendimit për emërimin e komisioneve etike dhe emërimin e Komisionit etikë janë indikatorët e rezultateve të arritura të kësaj masa të Planit të veprimit.

Mirëpo, Komuna e Ulqinit, në periudhën e kohëzgjatjes së këtij Plani të veprimit, nuk ka hartuar raportin për vlerësimin e zbatimit të standardeve të etikës publike.

Kuvendi komunal i Ulqinit ka miratuar Kodeksin etikë të zyrtarëve/eve dhe punonjësve/eve i cili u publikua në „Fletën zyrtare – dispozitat komunale“, nr. 39/2011 me datë 23.12.2011 dhe Kodeksin etikë të përfaqësuesve/eve dhe funksionarëve/eve në vetëqeverisje lokale i cili u publikua në „Fletën zyrtare – dispozitat komunale“, nr. 39/11 me datë 23.12.2011.

Nga ana tjetër, Kuvendi komunal i Ulqinit nuk e ka miratuar vendimin për emërimin e komisioneve etike dhe Vendimin për emërimin e anëtarëve të Komisioneve etike. Në informatat e dorëzuara nga Kuvendi i kësaj vetëqeverisje lokale theksohet se në periudhën e ardhshme do të iniciohet procesi i sjelljes së këtij vendimi dhe emërimi i anëtarëve të komisioneve etike.

Për këtë arsye, **zbatimi efikas i Kodeksit etik për zyrtarët dhe punonjësit lokal dhe Kodeksit etikë për përfaqësuesit dhe funksionarët e zgjedhur në Komunë të Ulqinit**, si **masa e 31** e Planit të veprimit, **nënshkrimi i deklaratës për pranimin e rregullave të sjelljes të përcaktuar me Kodeksin etikë (masa e 32), vendosja e evidencës (masa e 33)** dhe **zbatimi i standardeve (masa e 34) të etikës publike** nuk u realizuan.

Masa e 35 e Planit të veprimit për luftë kundër korrupsionit ka paraparë **përmirësimin e bashkëpunimit të organeve të Komunës së Ulqinit me qytetarë, OJQ dhe sektorin privat në luftë kundër korrupsionit.**

Sekretariati për administratë dhe veprimtari shoqërore dhe organet tjera komunale gjatë viteve 2014, 2015 dhe 2016 kanë mbajtur një sërë takimesh me qytetarët dhe sektorin joqeveritar në temën e luftës kundër korrupsionit në nivel lokal, me ç'rast janë hartuar edhe raportet nga ato mbledhje. Meqë, sipas shpjegimit të këtij resori qeveritar, qasja e raporteve nga takimet ka karakterin e sekretit zyrtar, nuk kishim mundësi të përcaktojmë numrin e saktë të takimeve, si dhe numrin e iniciativave të cilët në ato takime janë parashtruar.

Atë çfarë duhet theksuar është që Komuna e Ulqinit, në konkurset për financimin e projekteve, ka përkrahur OJQ-të të cilët janë marrë me çështjet e antikorrupsionit në këtë vetëqeverisje lokale.

Mirëpo, që kjo nuk është e mjaftueshme tregojnë rezultatet e anketës të cilën e ka bërë OJQ „Ul info" për perceptimin e korrupsionit të qytetarëve të kësaj komunë. Mbi 86 për qind e qytetarëve mendojnë se korrupsioni në komunën tonë është shumë ose kryesisht i përhapur. Është interesant e dhëna që vetëm një për qind e të anketuarve thonë se ai nuk është aspak i përhapur në Ulqin. Pra, qytetarët janë të vetëdijshëm për një nga sfidat më të mëdha me të cilat ballafaqohet kjo shoqëri, si tani ashtu edhe në vitet e ardhshme dhe për këtë arsye është e nevojshme që të bëhen përpjekjet shtesë që në bashkëpunim me qytetarët, OJQ-të dhe sektorin e biznesit të avancohet lufta kundër korrupsionit në këtë vetëqeverisje lokale.

Me rezultatet e kësaj ankete u dëshmua se gati 65 % e të anketuarve nuk kanë dëgjuar ose nuk dinë që Komuna e Ulqinit e ka përpiluar Planin lokal të veprimit për luftë kundër korrupsionit dhe se ai zbatohet, 20% ishin pa përgjigje, ndërsa vetëm rreth 15% dinë diçka për këtë temë.

Ky perceptim i qytetarëve nuk habit për arsye se gjatë viteve 2014 dhe 2015 janë mbajtur vetëm tre takime të përbashkëta në mes të organeve të vetëqeverisjes lokale, sektorit joqeveritar dhe sektorit privat me qëllim realizimin e masave të përcaktuara me Planin e veprimit për luftë kundër korrupsionit në Komunë të Ulqinit **(masa e 36).**

Rritja e shkallës së bashkëpunimit me OJQ dhe sektorin privat në temën e rregullimit hapësinor dhe ndërtimit të objekteve është **masa e tridhjetë e shtatë dhe tridhjetë e tetë** e Planit të veprimit për luftë kundër korrupsionit në Komunë të Ulqinit.

Mirëpo, në periudhën e kohëzgjatjes së Planit të veprimit, e as në vitin 2016, Sekretariati për planifikim hapësinor dhe zhvillim të qëndrueshëm nuk ka organizuar takime me sektorët e përmendura në temën e rregullimit hapësinor dhe ndërtimin e objekteve. Nëse dimë që komuna e Ulqinit ka mungesë të dokumentacionit planifikues, që, sipas të dhënave jozyrtare, në territorin e kësaj vetëqeverisje lokale ka mbi 80% të objekteve të ndërtuara pa leje, që, sipas hulumtimit tashmë të përmendur, mbi 80% e të anketuarve mendojnë se Qeveria e Malit të Zi dhe administrata lokale janë shumë ose kryesisht të korruptuara, që lartë në këtë listë janë të Mirat detare, Policia komunale dhe Drejtoria për punë inspektuese, dhe se perceptimi i tillë është krijuar, të paktën pjesërisht, për shkak të ndërtimit pa leje, atëherë është më shumë se e nevojshme pjesëmarrja më e madhe e të gjithë pjesëmarrësve për përmirësimin e situatës aktuale.

Indikatorët e rezultateve të arritura për masën e 38 të Planit të veprimit janë përcaktimi i modelit të bashkëpunimit të Kuvendit komunal të Ulqinit me sektorin joqeveritar në bazë të marrëveshjes së tyre për bashkëpunim.

Parlamenti i Ulqinit, në Rregulloren e vet të punës, ka vendosur kapitullin „numër 12“, nga neni 161 deri në nenin 163, i cili mban titullin „Pjesëmarrja e OJQ-ve“. Në këtë kapitull është përcaktuar mundësia e pjesëmarrjes në punën e Kuvendit dhe të trupave të saja punuese nëpërmjet institutit të „Karriges së lirë“.

Rregullorja e Kuvendit komunal të Ulqinit është publikuar në „Fletën zyrtare të MZ – dispozitat komunale“ nr. 17/08 dhe 14/12.

Vendimi i miratuar për kriteret, mënyrën dhe procesin e ndarjes së mjeteve organizatave joqeveritare është po ashtu një nga indikatorët e suksesit të masës së 38 të PV.

Komuna e Ulqinit në vitin 2014 miratoi Vendimin për kriteret, mënyrën dhe procesin e ndarjes së mjeteve OJQ-ve. Me këtë Vendim, përveç të tjerash, u përcaktua se mjetet me vlerë prej 0,5% deri në 1% të buxhetit vjetor të Komunës i ndahen organizatave joqeveritare të cilët janë të

regjistruara në Mal të Zi, me seli në komunë të Ulqinit, për projektet të cilët, në tërësi ose kryesisht, realizohen në territorin e kësaj komune.

Vendimi për kriteret, mënyrën dhe procesin e ndarjes së mjeteve organizatave joqeveritare u soll në bazë të nenit 116 të Ligjit për vetëqeverisje lokale. Me këtë nen është paraparë që bashkëpunimi në mes të organeve të vetëqeverisjes lokale dhe OJQ realizohet, në mes të tjerash, „me financimin e projekteve të organizatave joqeveritare me interes për banorët lokal, me kushte dhe sipas procesit të përcaktuar me aktin e përgjithshëm të komunës".

Monitorimi dhe evaluimi i Planit të veprimit të Komunës së Ulqinit me raportet e dorëzuara në kohë për realizimin e masave dhe aktiviteteve të përcaktuara me rezultatet e arritura ishte **masa e tridhjetë e nëntë** e këtij Plani të veprimit.

Mirëpo, për dallim nga Plani i integritetit, për të cilin Komuna e Ulqinit ka përpiluar raportin periodik të realizimit (06.04.2017), organet e kësaj vetëqeverisje lokale nuk kanë dorëzuar raportet vjetore Kuvendit komunal të Ulqinit për vitet 2014 dhe 2015.

Shkurtimisht, Komuna e Ulqinit duhet të vendos sistemin e matshëm të punësimit dhe avancimit të punëtorëve, në pajtim me nevojat. Prandaj duhet më shumë të fokusohet në vendosjen e qëllimeve brenda njësive të veta, me përcaktimin e shkallës së përgjegjësisë të të punësuarve me rastin e arritjes së qëllimit.

Më tej nevoja e Komunës dhe e zyrtarëve lokal të bashkëpunojnë me sektorin privat, sektorin civil dhe qytetarët, si shfrytëzues përfundimtar të shërbimeve të tyre, është masa parësore me të cilën do të përcaktohen nevojat afatgjate të qytetit, e jo vetëm benefitat afatshkurtre politiko – interesore të individëve dhe grupeve të individëve.

Zbatimi efikas i politikave të shëndetshme publike dhe zhvillimi ekonomik i qytetit i bazuar mbi ato ka rëndësi kyçe për jetën e dinjitetshme të qytetarëve të Ulqinit dhe përmirësimin dhe arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm socio – ekonomik të qytetit.

Prandaj, në vend të propozimeve, edhe një herë shkruajmë masat kyçe nga Plani lokal i veprimit për luftë kundër korrupsionit në Komunë të Ulqinit.

1. Rritja e shkallës së përgjegjësisë dhe profesionalizimit të punës së vetëqeverisjes lokale,

2. Përmirësimi i transparencës në procesin e planifikimit, miratimit të akteve dhe zbatimin e tyre me respektimin e parimit të pjesëmarrjes.
3. Kontrolli i rritur i brendshëm dhe i jashtëm i punës së vetëqeverisjes lokale
4. Forcimi i integritetit të njësive të vetëqeverisjes lokale dhe zbatimi i standardeve etike në vetëqeverisje lokale
5. Krijimi i kushteve dhe nxitja e sektorit civil dhe atij privat që të kyçen në luftë kundër korrupsionit në nivel lokal
6. Monitorimi i Planit lokal të veprimit për luftë kundër korrupsionit.

Pra, pikërisht siç është rasti me projektin i cili po implementohet, „Ulqini kundër korrupsionit“, kështu realizimi i masave kyçe nga plani lokal i veprimit do të kontribuojë **qëllimit të përgjithshëm** i cili është rritja e transparencës së punës së vetëqeverisjes lokale në luftë kundër korrupsionit në nivel lokal, si dhe **qëllimit specifik** i cili nënkupton kontributin e kyçjes së qytetarëve në luftë kundër korrupsionit në nivel lokal.